

V E N D I M
Nr.210, datë 28.4.1999

**PËR LEJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT PËR LËSHIMIN
E AUTORIZIMIT TË KALIMIT TË PRONËSISË PËR TROJET E OBJEKTEVE TË
PRIVATIZUARA NGA SHOQËRITË HUAMARRËSE**

(Ndryshuar me VKM nr. 565, datë 14.7.2010)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rastet kur shoqëritë huamarrëse, subjekte të kontrollit sipas ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1999 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, kanë kryer pagesa për trojet e objekteve të privatizuara nga *Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes të Pronave Publike, në Ministrinë e Financave*, përpara lëshimit të autorizimit për kalim pronësie të truallit nga kjo agjenci, veprimi financiar i kryer (pagesa) të konsiderohet i mirëqenë.

2. *Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes të Pronave Publike, në Ministrinë e Financave* t’u lëshojë autorizimet përkatëse, për kalim pronësie për trojet e këtyre objekteve, administratorëve të shoqërive huamarrëse, sipas kërkesës së tyre dhe dokumentacionit shoqërues.

3. Ngarkohen *Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes të Pronave Publike, në Ministrinë e Financave*, Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse dhe *Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme* për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko